

REPubLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE
Nr. 29091

29091

V E N D I M

PER RREGJISTRIMIN PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me 21/01.2003, une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, **Altina XHOXHAI**, pasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga kerkuesi **Zoti Rrapo SKENDERAJ** i biri i Zenelit dhe Lekos, lindur ne Fier, me 09.05.1966, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1356420, **Administrator i Shoqerise ne krijim e siper " EURO OFFICE " Sh.P.K.**,

per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise " **EURO OFFICE** " SHPK dhe pasi,

KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi **Rrapo SKENDERAJ**, per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise " **EURO OFFICE** " **Sh.P.K.**, e cila ka si ortake te saj zoterinjte Genci Likoskendaj dhe Rrapo Skenderaj, si objekt te veprimtarise Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme, Sherbime ne fushen e Informatikes dhe Elektronikes, Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke.

Administrator i Shoqerise eshte zoti Rrapo Skenderaj.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rrugen " Sulejman DELVINA ", prane Stadiumit Selman Stermasi - Tirane.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte nentedhjetenente vjet.

eshte e drejte dhe ne baze te Ligjit duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 " **Per Shoqerite Tregtare** " dhe Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 " **Per Rregjistrin Tregtar** "

V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " **EURO OFFICE** " SH.P.K., me ortake te saj zoterinjte **Genci Likoskendaj** dhe **Rrapo Skenderaj**, me objekt te veprimtarise : Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme, Sherbime ne fushen e Informatikes dhe Elektronikes, Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke.

Administratore i Shoqerise eshte zoti Rrapo Skenderaj.

Selia e shoqerise ndodhet ne Rruga " Sulejman DELVINA ", prane Stadiumit Selman Stermasi - Tirane.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte nentedhjetenente vjet.

Kunder Vendimit mund te behet ankim.

GJYQTARE

Altina XHOXHAI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. ~~29091~~ 29091, Vendimit

**V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane sot me date 30 05 .2003 une gjyqetarja Bl. Imeri
shkalles se pare Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura nga
Administratori :
RRAPO SKENDERAJ i biri i Zenelit i datelindjes 09.05.1966 , banues ne Tirane ,

K O N S T A T O V A :

Se me Vendimin e Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k (e njohur si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.29091 vendimi, date 31.01.2003,) date 21.05.2003 mbeshtetur edhe ne Statutin e Shoqerise eshte vendosur qe z.GENCI LIKOSKENDAJ , ti dhuroje z.RRAPO SKENDERAJ 70 % (shtatedhjete perqind) dhe ortak I vetem ne Shoqeri me 100% te kuotave dhe kapitalit mbetet Z. RRAPO SKENDERAJ.
Shoqeria do te kete administrator Z. RRAPO SKENDERAJ.

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore .

PER KETO ARESYE :


Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te Nenit 24 te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "Per Rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtare"

V E N D O S A :

Te urdheroj zyren e Regjistrit Tregtare per te depozituar Vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k date 21.05.2003 sipas te cilit ortak i vetem i shoqerise me 100% te kuotave dhe te kapitalit dhe Administratori saj do te jete Z. RRAPO SKENDERAJ .
Te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen . . rreshtin .

Tirane, me 30 05 . 2003

GJYQTARE



VENDIM
I GJYQTARIT TË VETEM

Ne Tirane, sot me date 12.07.2005, une Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, A. Ceço, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Rrapo Skenderaj, administrator i shoqerise "EURO OFFICE" SHPK

KONSTATOVA

Se me vendimin nr. 29091 date 31.01.2003 të Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeria "EURO OFFICE" shpk. Ortak i vetem dhe administrator I shoqerise eshte z. Rrapo Skenderaj, kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke, me seli ne Tirane. Me vendimin nr.1 date 28.01.2005, te Ortakut te Vetem te Shoqerise "EURO OFFICE" shpk, eshte vendosur:

- Zmadhimi I kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise "EURO OFFICE" shpk, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara, gjendje ne daten 31.12.2004.
- Te caktoje znj. Margarita Gjergji, anetare e IKEA, me profesion Eksperte Kontabel e Autorizuar, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31.12.2004.
- Depozitimim e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje të ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per Regjistrimin Tregtar dhe Formalitete qe duhet Respektuar " dhe ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ".

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimim e vendimit nr. 1 date 28.01.2005 të Ortakut te Vetem te shoqerise "EURO OFFICE" shpk sipas te cilit eshte vendosur :

- Zmadhimi I kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise "EURO OFFICE" shpk, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara, gjendje ne daten 31.12.2004.
- Te caktoje znj. Margarita Gjergji, anetare e IKEA, me profesion Eksperte Kontabel e Autorizuar, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31.12.2004.
- Depozitimim e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Urdherohet Zyra e Regjistrimit Tregtar të beje ndryshimet ne kollonat perkatese duke i ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije të kuqe.

GJYQTARE

A. Ceço
[Signature]

A K T

THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ EURO OFFICE ” SH.P.K.

Personat qe firmosin me poshte:

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664.

Zoti Rrapo SKENDERAJ i biri i Zenelit dhe Lekos, lindur ne Fier, me 09.05.1966, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1356420.

kane hartuar, si me poshte vijon, aktin e themelimit te nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me Legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 “ **Per Shoqerite Tregtare** “, aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe me dispozitat e Statutit te Shoqerise qe i bashkangjitet ketij Akti Themelues.



Emertimi Shoqerise eshte " EURO OFFICE " SH.P.K.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga " Sulejman DELVINA ", prane Stadiumit Selman Stermasi - Tirane.

Kohezgjatja e Shoqerise eshte 99 (nentedhjeteeente) vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

OBJEKTI i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme.

Sherbime ne fushen e Informatikes dhe Elektronikes.

Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise.

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke.

Ky kapital perbehet nga kontributet e me meposhteme ne para te ortakeve:

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, kontribuon me shumen 70.000 leke.

Zoti Rrapo SKENDERAJ kontribuon me shumen 30.000 leke.

Kapitali Themeltar eshte i ndare ne 100 pjese, plotesisht te shlyera, me vlere 1000 leke secila, te renditura sipas numrit te serise nga Nje ne 100.

Ne baze te kontributeve te lartpermendura :

Zoti Genci LIKOSKENDAJ merr 70 pjese te Kapitalit Themeltar, te renditura nga numri i serise Nje deri ne numrin e serise 70.

Zoti Rrapo SKENDERAJ merr 30 pjese te Kapitalit Themeltar, te renditura nga numri i serise 71 deri ne numrin e serise 100.

Te gjitha pjeset e Kapitalit Themeltar jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht.

Ortaket kane derdhur shumen koresponduese te pjeseve te nenshkruara.



Shuma e mbledhur prej tyre eshte depozituar ne **Banken Kombetare Tregtare Nr 1 - Tirane** ne nje llogari te hapur ne emer te **Shoqerise ne formim e siper**.

Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga ajo Banke.

Personat qe firmosin kete Akt pasi kane marre dijeni per kete certifikate, deklarojne se shuma e derdhur prej tyre eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne certifikate dhe se ata konfirmojne nenshkrimin e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumen respektive te derdhur.

Shoqeria do te administrohet nga nje ose disa administratore te cileve u jane besuar te gjitha plotfuqite per administrimin e saj, perjashtuar ato qe ligji dhe Statuti bashkengjitur ja rezervojne Asamblese.

Administratori ose administratoret do te jene te emeruar per tre vjet duke filluar nga emerimi i tyre dhe mund te shkarkohen nga Asamblea e Ortakeve.

Nepermjet ketij Akti emerohet si Administrator i Shoqerise **zoti Rrapo SKENDERAJ** i biri i Zenelit dhe Lekos, lindur ne Fier, me 09.05.1966, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1356420, te cilit i jepen te gjitha kompetencat, qe ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet per krijimin e shoqerise, parashikuar sipas ligjit ne fuqi.

Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise qe krijohet deri ne regjistrimin e saj ne gjykate, veçanerisht ai eshte i pajisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer te Shoqerise, te cilat i kalojne Shoqerise nga momenti i regjistrimit.

Perveç te tjerave, administratori eshte i ngarkuar per te kryer akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e Shoqerise dhe kompetencat e tij.

Pasi te behet regjistrimi i Shoqerise, keto akte dhe angazhime i nenshtrohen miratimit te bashkesise se ortakeve, jo me vone se sa nga data e mbledhjes se pare te Asamblese se Ortakeve, qe shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vitit te pare financiar.

Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te Shoqerise.



Ky Akti Themelimi është hartuar në Tiranë, më 14.01.2003, në pesë ekzemplare origjinale, duke pasur të gjithë ekzemplaret fuqi të barabartë ligjore.

FIRMOSUR NGA :

ORTAKET

Genci LIKOSKENDAJ

Rrapo SKENDERAJ

Genci Likoskendaj
Rrapo Skenderaj

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ EURO OFFICE ” SH.P.K.

Personat qe firmosin me poshte:

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, i biri i Laverit dhe Farfurise, lindur ne Fier, me 16.02.1969, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel - Tirane, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1765664.

Zoti Rrapo SKENDERAJ i biri i Zenelit dhe Lekos, lindur ne Fier, me 09.05.1966, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1356420.

kane hartuar, si me poshte vijon, statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

KREU I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 1

Forma



Krijohet nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, e cila e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht, por jo ekskluzivisht, Ligjen Nr.7638, date 19.11.1992 " **Per shoqerite tregtare** ", aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se Shoqerise, si dhe me dispozitat e ketij Statuti.

Neni 2
Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte " EURO OFFICE " SH.P.K.

Neni 3
Objekti i veprimtarise se shoqerise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte :

Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme.

Sherbime ne fushen e Informatikes dhe Elektronikes.

Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise.

Neni 4
Selia e shoqerise

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga " Sulejman DELVINA ", prane Stadiumit Selman Stermasi - Tirane.

Transferimi i selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter behet me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 5
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise 99 (nentedhjeteente) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Kjo periudhe mund te zgjatet tej ketij afati ose te shkurtohet kur Shoqeria priset para kohe.





KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar eshte 100.000 leke.

Ai eshte i ndare ne 100 pjese, plotesisht te shlyera, me vlere 1000 leke secila, te renditura sipas numrit te serise nga nje ne 100.

Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e pjeseve depozitohen ne **Banken Kombetare Tregtare Nr 1 - Tirane**, per llogari te Shoqerise qe krijohet.

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te pjeseve te reja, ortakët kane te drejten e perparësise ne nenshkrim, proporcionalisht me shumën e pjeseve te tyre, por ata jane te lire te heqin dore nga kjo e drejte.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj.

Zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asamblea e ortakëve me shumicën e ortakëve te pranishem ose te perfaqesuar, qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar. Zvogelimi i kapitalit i prek te gjithë ortakët ne raport me pjeset e tyre.

Neni 7 Kontributet e ortakëve ne kapitalin themeltar

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhteme ne para :

Zoti Genci LIKOSKENDAJ, kontribuon me shumën 70.000 leke.

Zoti Rrapo SKENDERAJ kontribuon me shumën 30.000 leke.

Neni 8 Pjeset e kapitalit themeltar

Ne baze te kontributeve te lartpermendura :

Zoti Genci LIKOSKENDAJ merr **70** pjese te **Kapitalit Themeltar**, te renditura nga numri i serise Nje deri ne numrin e serise **70**.

Zoti Rrapo SKENDERAJ merr **30** pjese te **Kapitalit Themeltar**, te renditura nga numri i serise **71** deri ne numrin e serise **100**.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar, nenshkruhen, shlyhen plotesisht pastaj shpermdahen ndermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme.

Neni 9

Lenia dhe transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, me rruge trashegimie dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'ju transferohen te treteve vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi $3/4$ e pjeseve te kapitalit dhe me kushte jo me te favorshme se ato qe i jane ofruar ortakeve.

KREU III



MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 10

Ortaket dhe Asambleja e Ortakeve

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.
Ne ushtrimin e te drejtes se tyre per te marre pjese ne vendimet kolektive, çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje ortak tjetër, ose nje person i zgjedhur prej tij.



Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar, nga administratori, nga ekspertet kontabel te autorizuar, po qe se ka te tille.

Mbledhja e Asamblese duhet te njoftohet nepermjet nje letre rekomande te derguar te pakten 15 dite para dates se caktuar per mbledhje.

Asamblea duhet te thirret te pakten nje here ne vit ndermjet 6-te muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e llogarise vjetore.

Asamblea thirret prane selise se shoqerise ose ne ndonje vend tjeter ne Shqiperi.

Thirrja duhet te permbaje ditën, orën dhe vendin e mbledhjes per mbledhjen e pare ose te dyte si dhe permbajtjen e problemeve qe do te trajtohen.

Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme.


Asamblea e zakonshme vendos per çeshtje te tilla si emerimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, percakton shperblimin e administratoreve dhe te ekspertit kontabel te autorizuar, vendos per problemet e tjera te drejtimit te shoqerise te paraqitura nga administratoret, etj.

Asamblea e jashtezakonshme vendos per çeshtje te tilla si ndryshimet e statutit, mbi kopetencat e likuidatoreve, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, shnderrimi i shoqerise ne shoqeri te formave te tjera etj.

Asamblea e zakonshme ne mbledhjen e pare mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nje numer ortakesh qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar dhe vendimet merren me shumice votashte mbi 1/2 e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

Ne qofte se mbledhja e pare e Asamblese se zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dyte e cila mund te marre vendime te vlefshme, pavaresisht se sa pjese te kapitalit themeltar zoterojne ortaket e pranishem ose te perfaqesuar dhe vendimet merren me nje shumice votash te mbi 1/2 te ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

Asamblea e jashtezakonshme kerkon kushte prezence ose perfaqesimi te njejte me ato te Asamblese se zakonshme si ne mbledhjen e pare ashtu edhe ne mbledhjen e dyte, por ajo merr vendime me shumice votash mbi 3/4 e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.





Neni 11 Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje ose disa administratore, qe duhet te jene persona fizike dhe mund te jene ose jo ortake ne shoqeri.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Emerimi i tyre behet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh nga emerimi i tyre me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem.

Ne maredhenie me ortaket dhe te tretet administratoret kane te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise, me perjashtim te atyre kopetencave qe ligji dhe statuti ja japin shprehimisht ortakeve.

Administratoret jane pergjegjies ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Neni 12 Ekspertet kontabel te autorizuar

Ne rast nevojje ose nese e kerkon ligji, kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite duke filluar nga data e emerimit te tyre me mundesi rizgjedhje nga shumica e ortakeve qe perfaqesojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU IV VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 13 Viti financiar, llogarite vjetore

Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Llogaritja vjetore, inventari, relacionet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asamblea me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behen brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 14 Dividentet

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asamblea e ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve mbi fitimin.

Fitimi, qe do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te çdo viti, deri sa ky fond te arrije vleren 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.


KREU V ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 15 Prishja

Shoqeria priset me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 5 te ketij statuti, me perjashtim te rasteve ku behet zgjatja e afatit sipas nenit 15 ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyeset e parashikuara me ligj.

Shoqeria nuk priset kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i paafte ose vdes.

Neni 16 Likuidimi



Shoqeria kjo ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj.

Per kryerjen e ketij procesi Asamblea emerone nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit Asamblea vendos, me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

Mbas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

KREU VI DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 17 Shnderrimi i Shoqerise

Shnderrimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose ne shoqeri komandite mund te kryhet vetem me miratimin unanim te ortakeve, ndersa shnderrimi ne shoqeri anonime, me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 18 Mosmarreveshjet

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit ndermjet ortakeve, ndermjet Shoqerise dhe ortakeve, do ti paraqiten per zgjidhje gjykatave kompetente shqiptare.

Dispozita Perfundimtare Neni 19

Ky Statut eshte hartuar ne Tirane, me 14.01.2003, ne pese ekzemplare origjinale, duke patur te gjithë tekstet fuqi te barabarte ligjore.




FIRMOSUR NGA:

Ortakët

Genc LIKOSKENDAJ

Rrapo SKENDERAJ

Genc Likoskendaj
Rrapo Skenderaj

Notere Majlinda LLESHI

Dhoma e Noterise Tirane

Rr" Sulejman Delvina "

Tel ++354555

Nr. 245 Rep Nr. 44 Kol

V È R T E T I M

Sot më datë 14.01.2003, në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht para meje ortaket e


Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

i "EURO OFFICE" SH.P.K.

Rrapo SKENDERAJ dhe Z. Genc LIKSKENDAJ

te cilet më deklaruan se *Statuti* i mësipërm është sipas vullnetit të tyre të lirë e të plotë dhe unë noteri duke e gjetur konform ligjit e vërtetoj atë .

NOTERE



29091/1

29091/1 B Mucaj
29.05.2003
99 05 2003
Mucaj

K E R K E S E

KERKUES:

RRAPO SKENDERAJ i biri i Zenelit i datelindjes 09.05.1966 , banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i njohur personalisht prej meje Noteres .

OBJEKTI : Depozitimim e Vendimit Nr. 1 te Ortakut te vetem te shoqerise "EURO OFFICE" sh.p.k. date 21.05.2003

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE T I R A N E

Me Vendimin Nr.1 te Ortakut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k. (e njohur si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 29091 date 31.01.2003) mbeshtetur edhe ne Statutin e Shoqerise eshte vendosur qe z.GENCI LIKOSKENDAJ ti dhuroje Z. RRAPO SKENDERAJ 70% te kapitalit dhe kuotat e kesaj shoqerise, dhe se bashku me kuotat e kapitalit te shoqerise edhe te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.sipas Kontrates se dhurimit bashkangjitur kesaj kerkese.

Shoqeria mbetet shoqeri me ortak te vetem dhe Administrator me 100 % te kuotave , Z. Rrapo Skenderaj .

Paraqes dokumentat e tjera prane Gjykates se Rrethit Tirane per te bere te mundur depozitimim ne zyren e Regjistrimit Tregtar te Vendimit te Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k

ADMINISTRATORI


Rrapo Skenderaj

*Vendimi Nr. 1 i petekut
si veshtim dt 21.05.03*
*kontrate dhurimi Nr 3385
680
dt 22.05.03*
*Bi depozituar
dt 30.05.03*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E
Nr. 3353 Rep

V E R T E T I M

Sot me date _____ .2003 , ne Zyren e Noterise Tirane u paraqit personalisht para meje **Administratori I Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k** per identitetin e te cilit u sigurova nga pasporta personale, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili me deklaroi se kerkesa e mesiperme eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe une noterja duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoi



K E R K E S E

KERKUES:

RRAPO SKENDERAJ i biri i Zenelit i datelindjes 09.05.1966 , banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i njohur personalisht prej meje Noteres .

OBJEKTI : Depozitimin e Vendimit Nr. 1 te Ortakut te vetem te shoqerise "EURO OFFICE" sh.p.k. date 21.05.2003

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE T I R A N E

Me Vendimin Nr.1 te Ortakut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k. (e njohur si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 29091 date 31.01.2003) mbeshtetur edhe ne Statutin e Shoqerise eshte vendosur qe z.GENCI LIKOSKENDAJ ti dhuroje Z. RRAPO SKENDERAJ 70% te kapitalit dhe kuotat e kesaj shoqerise, dhe se bashku me kuotat e kapitalit te shoqerise edhe te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.sipas Kontrates se dhurimit bashkangjitur kesaj kerkese. Shoqeria mbetet shoqeri me ortak te vetem dhe Administrator me 100 % te kuotave , Z. Rrapo Skenderaj .

Paraqes dokumentat e mia prane Gjykates se Rrethit Tirane per te bere te mundur depozitimin ne zyren e Regjistrat Tregtar te Vendimit te Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k

ADMINISTRATORI




REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E
Nr. 2989 Rep

V E R T E T I M

Sot me date 22.05 .2003, ne Zyren e Noterise Tirane u paraqit personalisht para meje Administratori I Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k per identitetin e te cilit u sigurova nga pasporta personale, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i cili me deklaroi se kerkesa e mesiperm eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe une noterja duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoi

NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE

TIRANE

Nr. 3305 Rep

Nr. 680 kol



**KONTRATE DHURIMI
KUOTASH DHE KAPITALESH**

Sot me date 22.05.2003, ne Zyren e Noterise, u paraqiten personalisht para meje
Noteres Majlinda Lleshi u paraqiten personalisht palet :

Ne cilesine e dhuruesit

GENCI LIKOSKENDAJ i biri i Laverit i datelindjes 16.02.1969 , banues ne Tirane ,
madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i identifikuar me pasaporten Nr
1765664.

BLERESI :

RRAPO SKENDERAJ i biri i Zenelit i datelindjes 09.05.1966 , banues ne Tirane ,
madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar i njohur personalisht prej meje
Noteres .

te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate :

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 29091 date 31.01.2003 eshte
regjistruar si person juridik, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" sh.p.k. ,
me ortake **Z. GENCI LIKOSKENDAJ** dhe **Z. RRAPO SKENDERAJ**.

Duke u mbeshtetur veprimtarine e shoqerise ne Statutin dhe Kontraten e Themelimit ortaket
zoterojne perkatesisht **GENCI LIKOSKENDAJ** - 70% dhe **RRAPO SKENDERAJ** -30% te
kapitalit fillestar dhe te kuotave .

Ne baze te Vendimit Nr.1 date 21.05.2003 te Ortakeve te kesaj shoqerie, **Z. GENCI
LIKOSKENDAJ** i dhuron 70% te kapitalit fillestar dhe kuotat e kesaj shoqerie **z.RRAPO
SKENDERAJ** pa asnje kusht e shperblim dhe me vullnet te lire e te plote.

Z.RRAPO SKENDERAJ e pranon me kenaqesi dhurimin si me siper per 70 % te
kapitalit te shoqerise se mesiperme.

Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te dhuruar, (70 %) **Z.RRAPO
SKENDERAJ** pranon edhe te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje
me te tretet dhe me organet shtetore.


Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhurimi, dhuruesi **GENCI LIKOSKENDAJ**
humbet çdo te drejte pronesie mbi 70% te kapitalit i cili i kalon teresisht **z.RRAPO
SKENDERAJ** .

Shoqeria shenderrohet ne shoqeri me ortak te vetem :**z.RRAPO SKENDERAJ**
100%.

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje me fuqi-te barabarte ligjore dhe duke qene e
bazuar ne ligj vertetohet prej meje noteres

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT



SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EURO OFFICE" sh.p.k



V E N D I M Nr. 1
I ORTAKEVE TE SHOQERISE
"EURO OFFICE" sh.p.k.

Sot me date 21.05.2003 ne, ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
"EURO OFFICE" sh.p.k GENCI LIKOSKENDAJ dhe RRAPO SKENDERAJ ne
mbledhjen e jashtezakonshme

V E N D O S A :

1. Ne baze te Nenit 33 te ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare"
Z.GENCI LIKOSKENDAJ t'i dhuroje Z. RRAPO SKENDERAJ 70% (shtatedhjete perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise "EURO OFFICE" sh.p.k dhe shoqeria do te shenderrohet nga shoqeri me dy ortake ne shoqeri me ortak te vetem :
RRAPO SKENDERAJ 100 %.
Dhurimi do te behet me Kontrate - Dhurimi para Noteres, kontrate e cila do t'i bashkangjitet ketij vendimi.
2. Administrator I shoqerise mbetet Z. RRAPO SKENDERAJ.
3. Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te dhuruar, Z.RRAPO SKENDERAJ pranon edhe 70 % te detyrimeve ligjore qe ka shoqeria , ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.
3. Une GENCI LIKOSKENDAJ me nenshkrimin e Kontrates se Dhurimit çvishem nga pronesia mbi 70 % te kapitalit te shoqerise dhe largohet nga shoqeria.

ORTAKET E SHOQERISE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EURO OFFICE" sh.p.k.

Rrapo
Skenderaj

Jene Likoskendaj

2805/2 SA Cavo
KERKESE 05 KORRI 2005

KERKUES : Rrapo Skenderaj, shtetas shqiptar, madhore me zotesi të plote juridike per të vepruar, administrator i shoqerise "EURO OFFICE" shpk.

OBJEKTI : Depozitim e vendimit nr. 1 date 28.01.2005 te Ortakut të vetem të shoqerise "EURO OFFICE" shpk.

Baza Ligjore : Ligji 7667 date 28.01.1993, ligji 7638 date 19.11.1992.

PERPARA

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Me vendimin nr. 29091 date 31.01.2003 të Gjykatës së Shkalles së Pare Tirane, është regjistruar shoqeria tregtare "EURO OFFICE" shpk. Ortak i vetem dhe administrator i shoqerise është z. Rrapo Skenderaj, kapitali themeltar i shoqerise është 100.000 leke, me seli ne Tirane.

Me vendimin nr.1 date 28.01.2005, te Ortakut te Vetem te Shoqerise "EURO OFFICE" shpk, është vendosur :

- Zmadhimi i kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise "EURO OFFICE" shpk, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara, gjendje ne daten 31.12.2004.
- Te caktoje znj. Margarita Gjergji, anetare e IKEA, me profesion Eksperte Kontabel e AutORIZUAR, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31.12.2004.
- Depozitim e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykatës së Shkalles së Pare Tirane. Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrimin Tregtar dhe Formalitetet qe duhet respektuar per Shoqerite Tregtare", kerkojme nga Gjykata e Shkalles se pare Tirane, qe te behet i mundur depozitimi i ketij vendimi, prane Zyres se Regjistrimit Tregtar dhe nenvizimin e ndryshimeve perkatese ne skeden e shoqerise sipas ligjit.



ADMINISTRATOR

Rrapo Skenderaj
RRAPPO SKENDERAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR.5102Rep.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 2/06/2005, perpara meje noterës S. Merko, u paraqit personalisht z. Rrapo Skenderaj, shtetas shqiptar, administrator i shoqerise "EURO OFFICE", i njohur personalisht prej meje, i cili deklaroi se kerkesa e mesiperme është hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij të lire e të plote dhe e nenshkroi regullisht perpara meje noterës dhe tate noterja e vertetoj ate sipas ligjit.



S. Merko

VENDIM
Nr.1 date 28.01.2005
I ORTAKUT TË VETEM
TË SHOQERISE "EURO OFFICE" shpk

Ne Seline e Shoqerise "EURO OFFICE." shpk u zhvillua mbledhja e Ortakut të Vetem të Shoqerise per të shqyrtuar situaten financiare të shoqerise dhe mundesine e zmadhimit të kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara te shoqerise, gjendje ne daten 31.12.2004, dhe ne perfundim,

V E N D O S A

- Zmadhimin e kapitalit themeltar te nenshkruar te shoqerise "EURO OFFICE" shpk, nepermjet rezervave dhe fitimeve te pashperndara, gjendje ne daten 31.12.2004.
- Caktimin e znj. Margarita Gjergji, anetare e IKEA, me profesion Eksperte Kontabel e Autorizuar, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashperndara te shoqerise, gjendje te dates 31.12.2004.
- Depozitimim e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Ngarkohet administratori i shoqerise z. Rrapo Skenderaj të ndjeke procedurat ligjore per depozitimim e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrimit Tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.


ORTAKU I VETEM

RRAPPO SKENDERAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 102 Rep.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 29/01/2005, perpara meje noteres S. Merko, u paraqit personalisht z. Rrapo Skenderaj, shtetas shqiptar, ortak i vetem i shoqerise "EURO OFFICE", per identitetin e të cilit u njoha nga dokumenti personal i identifikimit, i cili deklaroi se vendimi i mesiperm eshte hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij të lire e të plote dhe e nenshkroi regullisht perpara meje noteres dhe me noterija e vertetoj ate sipas ligjit.



NOTERE
SILVANA MERKO

z: Aljona Xhushy
H. 01. 2003
[Signature]

K E R K E S E

Kerkues: Zoti Rrapo SKENDERAJ i biri i Zenelit dhe Lekos, lindur ne Fier, me 09.05.1966, banues ne Tirane, Blloku i Vilave, Selite e Vogel, me shtetesi shqiptare, me numer pasaporte 1356420 Administrator i Shoqerise ne krijim e siper "EURO OFFICE" Sh.P.K.

29091

OBJEKTI: Regjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar STAPLES "Sh. P. K

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.7638, date 10.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin tregtar ...".

[Handwritten notes:]
M. J. ...
dat 27/1/03
G. M. ...
A. ...

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE



Ne perputhje me normat perkatese te Legjislacionit shqiptar, zoti **Gene LIKSKENDAJ** dhe zoti **Rrapo SKENDERAJ** kane krijuar Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "EURO OFFICE" Sh.P.K.

Objekti i veprimtarise se saj eshte: Tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshme; Sherbime ne fushen e Informatikes dhe Elektronikes; Importimi dhe Eksportimi i paisjeve te zyrave dhe te kancelerise.

Shoqeria ka depozituar prane Bankes Kombetare Tregtare Nr 1 kapitalin themeltar te saj, i cili eshte 100.000 leke, qe sherben sipas ligjes si kapital themeltar minimal. Ne dokumentat e Shoqerise eshte percaktuar forma e saj, qe eshte SH.P.K.

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rruga "Sulejman DELVINA", prane Stadiumit Selman Stermasi - Tirane.


Kohezgjatja e Shoqerise eshte nentredhjetenete vjet.
Administrator i Shoqerise eshte Rrapo SKENDERAJ.
Bashkelidhur ju paraqesim dokumentet e nevojshme.

[Handwritten notes:]
Te regjistruar
3/1/03
G. M. ...
A. ...

KERKUES
Administratori
Rrapo SKENDERAJ

[Signature]

Tirane, me 14.01.2003



DEGA TIRANA 1

Bulevardi 'Zhan d'Ark'

Tel:++355(0)4 266276/7/8

Fax:++355(0)4 266282


Tirane, me 16/01/2003

VERTETIM

Me te cilen vertetojme se Z. Rrapo SKENDERAJ ka depozituar prane deges se BKT-se Tirana 1, per llogari te "EURO OFFICE" SHPK ne krijim e siper dt. 16/01/2003 shumen prej 100.000 LEK qe perfaqson shumen e kapitalit themeltar te shoqerise.

DREJTORI

TURAN SAJA



Notere Majlinda LLESHI
Dhoma e Noterise Tirane
Rr. "Sulejman Delvina"
Tel ++35555
Nr. 244 Rep Nr. 43 Kol

V È R T E T I M

Sot më datë 14.01.2003, në Zyrën e Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht para meje ortakët e

**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
i "EURO OFFICE" SH.P.K.**

Rrapo SKENDERAJ dhe Z. Genc LIKSKENDAJ

te cilet më deklaruan se Kontrata e themelimit e mësipërme është sipas vullnetit të tyre të lirë e të plotë dhe unë noteri duke e gjetur konform ligjit e vërtetoj atë .

NOTERE

